



**MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI
NDËRMJET:
KOMUNËS SË GJAKOVËS
DHE
SHOQATA AFRISTE E GRUAS (SHE-ERA)**

**Neni 1
Përfaqësimi i palëve**

Palët nënshkruese të kësaj marrëveshjeje garantojnë se ata kanë autorizimet e nevojshme për përmbushjen e obligimeve nga kjo marrëveshje e bashkëpunimit, se nënshkruesit e marrëveshjes së bashkëpunimit kanë zotësinë juridike për lidhje dhe nënshkrimin e së njëjtës në emër dhe për llogari të të njëjtëve, dhe se lidhja dhe përmbushja e obligimeve që dalin kjo marrëveshje është e lejuar më ligj. Palët në rastin e nënshkrimit përfaqësohen nga:

1. *Komuna e Gjakovës (në vijim "Komuna"), me adresë në Rr. UÇK nr. 53, Gjakovë 50000, Republika e Kosovës, përfaqësohet nga Kryetari i Komunës – Ardian Gjini.*
2. *Shoqata Afariste e Gruas – SHE-ERA (në vijim "SHE-ERA"), me adresë në Rr. Sylejman Hadum Aga Nr. , Republika e Kosovës, me numër të regjistrimit 5112039-6 si dhe numrin fiskal 600279253, përfaqësohet nga Drejtoresha Ekzekutive – Mirlinda Kusari Purrini.*

Më tutje në tekst: PALËT.

**Neni 2
Qëllimet**

1. Ky marrëveshje bashkëpunimi ka për qëllim të rregullojë bashkëveprimin në mes të Komunës dhe SHE-ERAs në zbatimin e projektit "Uji i Pastër në Gjakovë dhe Kukës", që përkrahet financiarisht nga programi i BE për bashkëpunim ndër-kufitar Shqipëri-Kosovë, dhe që do të zbatohet në periudhën 2020 – 2022.
2. Kjo marrëveshje zbërthen përgjegjësitë e palëve që burojnë nga projekti sipas përshkrimeve në projekt-propozim, që është zhvilluar bashkërisht nga partnerët, dhe që ka rezultuar me dhënie të grantit nga BE, që do të zbatohet nën udhëheqjen e përgjithshme të SHE-ERA në të dy anët e kufirit.
3. Palët do të bashkëpunojnë rreth përmirësimit të cilësisë së ujërave në Rajonin e Gjakovës dhe më gjerë në rajonin ndër-kufitar, si dhe përfshirjen e komuniteteve lokale dhe shoqërisë civile në planifikimin dhe zbatimin efikas të politikave të qëndrueshme për ujërat.

**Neni 3
Fushat e bashkëpunimit**

Në kuadër të Projektit "Uji i Pastër në Kukës dhe Gjakovë", palët dakordohen të bashkëpunojnë në lidhje me fushat e mëposhtme:

1. Përfshirjen e qytetarëve dhe komuniteteve lokale në proceset planifikuese dhe monitoruese të politikave të ujërave.
2. Zhvillimi i strategjisë dhe planit për ujërat, dhe monitorimi i zbatimit të saj.
3. Monitorimin e vazhdueshëm të cilësisë së ujërave në Komunën e Gjakovës.

4. Rregullimi i pjesshëm i shtratis të Lumit Llukac dhe Rrjetit të Kanalizimit përgjatë lagjeve ku do të rregullohet shtrati.
5. Angazhimi i të rinjëve në identifikimin e problemeve në komunitete lokale dhe transformimin e tyre në projekte apo kampanja sociale që synojnë zgjidhjen e këtyre problemeve.
6. Krijimi i kanaleve efektive të komunikimit në mes komunës dhe të rinjëve të komunës.

Neni 4

Obligimet e palëve

Sipas kësaj marrëveshje, palët pranojnë përgjegjësitë dhe obligohen si vijon:

1. Obligimet dhe përgjegjësitë e Komunës përfshijnë:

- a) Të marr vendimin për iniciimin e Bordit Rajonal Këshillëdhënës të Ujërave;
- b) Pjesëmarrje në nivel të lartë në organizimet informuese me qytetarë rreth politikave, problemeve dhe programeve komunale rreth ujërave, në koordinim me SHE-ERA;
- c) Asistimi në formimin e rrjeteve lokale me të rinjtë, përfaqësues komunal dhe asamblastë të kuvendit komunal, për angazhimin e tyre në projekte dhe iniciativa lokale në mbrojtje të ujërave;
- d) Diskutimi i politikave të ujërave në Asamble Komunale;
- e) Asistimi në Zhvillimin e Dosjes së Tenderit me informata teknike, ekspertizë dhe delegim të përfaqësuesve në proces;
- f) Zhvillimi i planit të detajuar të punëve infrastrukturore (shtrati i lumit dhe kanalizimi);
- g) Sigurimi i lejeve të ndërtimit, pëlqimet ambientale, dhe dokumentacionit tjetër të nevojshëm për projektin e shtratis të lumit dhe kanalizimit para se të shpallet tenderi për punë;
- h) Sigurimi i bashkëfinancimit për projektin sipas marrëveshjes paraprake dhe Letrës së Zotimit të dërguar sekretariatit të programit me datën 07.06.2019, në vlerë prej 134,484.35 EURO (9.5% të vlerës totale të projektit);
- i) Asistimin e SHE-ERA dhe të rinjëve në zbatimin e iniciativave lokale gjatë periudhës së zbatimit të projektit.

2. Obligimet dhe përgjegjësitë e SHE-ERA përfshijnë:

- a) Menaxhimin e gjithmbarshëm të projektit dhe koordinimin në mes të partnerëve;
- b) Raportimin tek donatori i projektit dhe monitorimi i përditshëm i aktiviteteve të projektit;
- c) Të sigurohet që procedurat e BE-së sipas kushteve të përgjithshme dhe të veçanta të kontratës së nënshkruar me donatorin, respektohen në plotësi;
- d) Themelimin, dhe facilitimin e Komisionit mbikëqyrës të Projektit (Project Oversight Committee – POC);
- e) Organizimin e aktiviteteve me komunitete dhe shoqëri civile, si dëgjime publike, takime planifikuese, si dhe monitorimin e cilësisë së ujërave në rajonin ndër-kufitar;
- f) Organizimin e takimeve me komunitete lokale dhe identifikimin e të rinjëve të ri që mund t'i bashkëngjiten iniciativave lokale;
- g) Menaxhimin e fondeve, administrimin e Auditimit financiar të jashtëm sipas kritereve të BE-së;
- h) Organizimin e të rinjëve në ndjekjen e një seance në asamblenë komunale;
- i) Promovimin e aktiviteteve dhe rezultateve të projektit në tërë territorin e mbuluar nga granti;
- j) Koordinimin e punë-kryesve dhe ofruesve të shërbimeve në realizimin e aktiviteteve të projektit;
- k) Aktivitetet e përcaktuara të monitorimit dhe vlerësimin siç parashihet në projekt propozim (Shih Shtojcën 3: Korniza Logjike);
- l) Të gjitha përgjegjësitë e tjera në kuadër të projektit, të cilat nuk i jepen në mënyrë eksplicite tek asnjë partner në projekt, dhe që nevojiten për realizimin e projektit sipas standardeve dhe procedurave të BE-së.

Neni 5

Komunikimi në mes palëve

1. Palët angazhohen të mbajnë komunikim të vazhdueshëm mes tyre dhe të shkëmbejnë çdo informacion të nevojshëm për përmbushjen e detyrave të tyre. Komunikimi do të kryhet në mënyrë verbale dhe me shkrim.

2. Palët do të caktojnë personat kontaktues që do të jenë përgjegjës për shkëmbimin e informatave dhe plotësimin të kërkesave të tyre për zbatimin e marrëveshjes së bashkëpunimit.
3. Palët do të informojnë njëri-tjetrin mbi personat e kontaktit jo më vonë se dy (2) javë nga nënshkrimi i kësaj marrëveshjeje.
4. Personat kontaktues nga të dyja palët do të jenë të disponueshëm në çdo kohë për komunikim dhe koordinim, me qëllim të dakordimit për veprimet që duhet të ndërmerren.
5. Palët gjithashtu do të delegojnë përfaqësuesin e tyre në POC.

Neni 6

Kohëzgjatja e Marrëveshjes së Bashkëpunimit

Palët nënshkruese të kësaj marrëveshjeje dakordohen që ajo të hyjë në fuqi në datën e nënshkrimit nga të dyja palët dhe do të zgjasë për një periudhë deri në përfundim të projektit.

Neni 7

Shkëputja e Marrëveshjes së Bashkëpunimit

1. Kjo marrëveshje e bashkëpunimit mund të shkëputet para afatit të skadimit me dakordim nga të dy palët nënshkruese, apo me kërkesë të njëres palë, me lajmërim paraprak me shkrim prej së paku dy (2) javësh.
2. Kjo marrëveshje e bashkëpunimit është i bazuar në mirëbesim dhe nuk ka për qëllim të përfitojnë palët të treta. Shkëputja mund të ndodhë në rastin nëse cila do palë është dëmtuar materialisht apo moralisht me veprime të qëllimshme apo të shkaktuara nga pakujdesia e palës tjetër.
3. Kjo marrëveshje nuk parasheh implikime financiare në mes të dy palëve jashtë buxhetit të projektit dhe zotimet e palëve në kohën e aplikimit (shih Shtojcën 2: Buxheti).

Neni 8

Gjuha e përdorur

1. Dokumenti i marrëveshjes së bashkëpunimit në mes palëve është shkruar në gjuhën shqipe.
2. Sipas nevojave të palëve marrëveshja mund të përkthet edhe në gjuhën serbe apo angleze, me pëlqimin paraprak të palëve.

Neni 9

Hyrja në fuqi


Kjo marrëveshje nënshkruhet me datë _____ në Gjakovë dhe hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

Neni 10

Dispozitat kalimtare

1. Kjo marrëveshje e bashkëpunimit rregullohet sipas dispozitave të ligjeve në fuqi në Kosovë.
2. Kjo marrëveshje e bashkëpunimit mund të modifikohet në çdo kohë me pëlqimin e palëve, dhe kërkesa për modifikim duhet të dorëzohet te pala tjetër së paku dy (2) javë para datës së synuar të modifikimit.
3. Kjo marrëveshje e bashkëpunimit përgatitet dhe nënshkruhet në dy (2) kopje origjinale, nga një për secilën prej palëve.


SHE-ERA



Drejtori Ekzekutiv
Mirinda Kusari-Purrini

Gjakovë, me: _____

Komuna e Gjakovës



Kryetari i Komunës
Ardian Gjini

Gjakovë, me: _____

